



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu

Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 4/590
Datë: 22 / 12 / 2025

Senati i Universitetit të Prishtinës, në kuadër të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 20, në zbatim të neneve 148, 152, 153, 154 dhe 155 të Statutit të UP-së, në përputhje me Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe Ligjin nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, Rregulloren nr. 1/282, dt. 03.06.2025, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, avancimin dhe rizgjedhjen e personelit akademik, në mbledhjen e mbajtur më 17.12.2025, vendosi të

shpallë

K O N K U R S

për emërimin e personelit akademik në njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës

FAKULTETI FILOZOFIK

1. Një **mësimdhënës** për lëndët: Estetika (O), Histori e filozofisë IV: Filozofi bashkëkohore (O), Teoria kritike e shoqërisë (Z), Foucault: Pushteti dhe dija (O), Filozofi e mediave (Z), Mbi konceptin e Communitas dhe Immunitas (Z).
2. Një **mësimdhënës** për lëndët: Puna me të rinjtë (O), Puna sociale me persona në konflikt me ligjin (O), Supervizioni i punës praktike (O), Kultura dhe puna sociale (Z), Avokimi dhe fuqizimi (Z).
3. Një **mësimdhënës** për lëndët: Metodatat kuantitative në sociologji (O), Sociologji e kulturës (O), Mediat dhe shoqëria (Z), Sociologji e komunikimeve masive (O), Sociologji e jetës së përditshme (Z), Seminari i punimit të diplomës (O).
4. Një **mësimdhënës** për lëndët: Hyrje në arkeologji (O), Histori e qytetërimeve (O), Trashëgimia arkeologjike e Kosovës (O), Historia e religjioneve (Z).
5. Një **mësimdhënës** për lëndët: Shkrim akademik dhe mendim kritik (O), Hyrje në metodologji të shkencës politike (O), Metodatat kualitative dhe kuantitative në shkencën politike (O), Ekonomia politike ndërkombëtare (O), Metodatat e hulumtimit dhe analiza (O).
6. Një **asistent** për lëndët: Filozofi politike I (O), Filozofi e së drejtës (O), Filozofi politike II (O), Debatet mbi globalizmin (Z), Histori e filozofisë II – Empirizmi dhe racionalizmi (O), Teoritë e demokracisë (Z), Histori e filozofisë III – Idealizmi klasik gjerman (O), Teoritë filozofike të drejtësisë (O), Hyrje në ideologjitë moderne (O), Populizmi në shek. 21 (O).
7. Një **asistent** për lëndët: Të drejtat e njeriut (O), Hyrje në politikatat sociale (O), Puna me të rinjtë (Z), Socializimi dhe integrimi (O), Sjellja njerëzore dhe mjedisi social (O), Metodatat e punës sociale: Puna me raste (O), Bazat e statistikës dhe hulumtimet kuantitative (O), Puna sociale në shkollë (O), Metodatat e punës sociale: Mediacion (O), Etika në punë sociale (O).
8. Një **asistent** për lëndët: Metodatat kuantitative në sociologji (O), Lëvizjet shoqërore dhe protesta (O), Praktikumi sociologjik (O), Sociologji e punës (O), Metodatat kualitative në

- sociologji (O), Sociologji politike (O), Shkenca, teknologjia dhe shoqëria (Z), Edukimi qytetar dhe demokracia (O).
9. Një **asistent** për lëndët: Shkrim akademik (O), Sociologji e arsimit (Z), Sociologji e shëndetit dhe sëmundjes (O), Mendimi social bashkëkohor (O), Migrimet dhe diaspora (O), Mjedisi dhe shoqëria (Z), Të drejtat e njeriut dhe drejtësia sociale (Z), Sociologji e jetës së përditshme (Z), Mendimi social shqiptar (O).
 10. Një **asistent** për lëndët: Histori botërore bashkëkohore I (O), Histori botërore bashkëkohore II (O), Histori e Evropës Juglindore III (O), Histori e diplomacisë II (O), Historiografi shqiptare shek. XIX-XX (O), Histori e Evropës Juglindore II (O), Historiografi botërore, shek. XIX - XX (O), Histori ekonomike e Ballkanit shek. XIX - XX (O), Restaurimi dhe konservimi i lëndës arkivore (Z), Praktikë institucionale arkivore (O).
 11. Një **asistent** për lëndët: Shkathhtësi intervistimi (O), Psikologji personaliteti (O), Psikologjia e shëndetit dhe mirëqenies (O), Psikopatologji e avancuar (O), Testimi, vlerësimi dhe diagnostikimi në psikologjinë klinike (O), Metoda hulumtimi të avancuara (O), Praktikum I (O, qendra të shëndetit mendor në komunitet), Zhvillimi dhe zbatimi i intervenimeve parandaluese në shkolla (O), Psikologji e përgjithshme (O).
 12. Një **asistent** për lëndët: Zhvillimi dhe vlerësimi i programeve (Z), Intervista terapeutike (O), Neuropsikologji (O), Biopsikologji (O), Çështje etike dhe profesionale në shëndetin mendor (O), Shkrim akademik për psikologji (O), Metoda hulumtimi të avancuara (O), Teoritë bashkëkohore të intervenimit në komunitet (O).
 13. Një **asistent** për lëndët: Hyrje në shkencë politike (O), Shkrim akademik dhe mendim kritik (O), Hyrje në politikën krahasimtare (O), Hyrje në metodologji të shkencës politike (O), Metodatat kualitative dhe kuantitative në shkencën politike (O).

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT

1. Një **mësimdhënës** për lëndët: Punët tokësore dhe mekanizim (O), Konstruksionet metalike në ndërtimtari (O), Konstruksionet e çelikut (Z), Punë praktike (Z), Fizika e ndërtimit (Z, Konstruktiv), Fizika e ndërtimit (Z, Hidroteknik).
2. Një **mësimdhënës** për lëndët: Teoria e strukturave (O), Metodologjia hulumtuese shkencore (O), Analiza jolineare e strukturave (Z), Mekanika II (Z), Teoria e strukturave – arkitekturë (O).
3. Një **mësimdhënës** për lëndët: Hyrje në inxhinierinë e ambientit (O), Ekonomia në inxhinieri (Z), Ndikimi i planifikimit urban në ambient (O), Ekologjia e përgjithshme (Z), Mikrobiologjia ambientale (O), Projektimi i deponive (Z).
4. Një **asistent** për lëndët: Teknologjia e betonit (O), Materialet ndërtimore (O), Projektimi i deponive (Z), Fizika e ndërtimit (Z, Hidroteknik), Fizika e ndërtimit (Z, Konstruktiv), Teknologjia e betonit (Z), Materialet polimere dhe aplikimet në inxhinierinë e ambientit (Z), Materiale të ndërtimit (O), Materialet e ndërtimit I (O), Materialet e ndërtimit II (O).
5. Një **asistent** për lëndët: Bazat e gjeoinformatikës (O), Pozicionimi satelitor (O), Rrjetat gjeodezike (O), Matje në terren me instrumente gjeodezike (O), Rregullimi i tokës (O), Menaxhimi i tokës (O), Sistemi i navigimit global satelitor (O), Gjeodezia fizike dhe tektonika (O), Bazat e GIS-it (Z).

FAKULTETI I FILOLOGJISË

1. Një **mësimdhënës** për lëndët: Gjuhë angleze I (O, Histori), Gjuhë angleze II (O, Histori), Gjuhë angleze (O, Shkencë Politike), Gjuhë angleze (O, Shkencë Politike) Gjuhë angleze I (Z, Antropologji), Gjuhë angleze II (Z, Antropologji), Gjuhë angleze për psikologji (O, Psikologji). (Për Fakultetin Filozofik)

Kushtet e përgjithshme

Kushtet e përgjithshme për emërimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës janë të përcaktuara në dispozitat përkatëse të [Statutit të UP-së](#), si dhe në [Rregulloren nr. 1/282, dt. 03.06.2025](#), për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin dhe rizgjedhjen e personelit akademik.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

Kandidatët të cilët aplikojnë për pozitat në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim.
2. CV-në akademike, të plotë me të gjitha të arriturat, me DOI të publikimeve, me vegëza aktive, (në formatin WORD dha atë PDF).
3. Certifikatën e lindjes.
4. Diplomat (baçelor, master/magjistraturë dhe doktoratë, ose diplomën/at e programeve të integruara).
5. Vendimin/et për nostrifikim të diplomës/diplomave ose dëshminë e aplikimit për nostrifikim (vlen vetëm për kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit).
6. Certifikatat e notave të studimeve baçelor dhe master/magjistraturë (vlen vetëm për kandidatët që konkurrojnë për asistentë).
7. Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale brenda kornizës së përcaktuar me Statutin e UP-së dhe Rregulloret në fuqi për emërim, riemërim dhe avancim të personelit akademik (në formatin WORD dhe të njëjtat edhe në atë PDF).
8. Dëshmitë për përvojën e punës në mësimdhënie në institucionet dhe programet e akredituara të arsimit të lartë në vend apo jashtë vendit.
9. Dëshmi të lëshuar nga Gjykata Themelore që nuk janë të dënuar.
10. Të gjitha informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme.
11. Deklaratë me shkrim për gatishmëri të dorëheqjes nga vendi paraprak i punës në rast të zgjedhjes nga senati.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuara nga noteri.

Dispozita të përgjithshme dhe kufizime për menaxhimin e procesit të emërimeve në UP

1. Të gjitha emërimet për tituj akademikë dhe kohëzgjatja e punësimit realizohen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të Universitetit të Prishtinës.
2. Emërimi nuk është proces automatik; ai është konkurrues dhe bazohet në ligjshmëri dhe në meritokraci për të gjitha pozitat akademike.
3. Kandidatët që aplikojnë për themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës për herë të parë në UP, të cilët janë të punësuar në një institucion publik ose privat (brenda ose jashtë vendit), si dhe në ndërmarrje ose persona juridikë të çfarëdo statusi, janë të detyruar që para nënshkrimit të kontratës së punës me UP-në, të sjellin dëshmi për dorëheqje të parevokueshme nga punëdhënësi paraprak. Nëse nuk e paraqesin këtë dëshmi, nuk mund të nënshkruajnë kontratë pune me Universitetin e Prishtinës.
4. Kriteri i moshës, i përcaktuar sipas nenit 154, paragrafi 1.2, të Statutit të UP-së, vlen për kandidatët që aplikojnë për themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës dhe merret parasysh deri në ditën e mbylljes së afatit të konkursit. Nëse një kandidat ka qenë i angazhuar si bashkëpunëtor i jashtëm në UP para arritjes së moshës së përcaktuar në statut, kjo nuk

nënkupton përjashtim nga kriteri i moshës në momentin e themelimit të marrëdhënies së rregullt të punës.

5. Në Universitetin e Prishtinës nuk mund të emërohen, sipas dispozitave të statutit, kandidatët që kanë të punësuar në njësinë përkatëse akademike persona në marrëdhënie familjare në kategoritë:
 - a) bashkëshorti ose personi me të cilin bashkëjeton;
 - b) i afërm në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime;
 - c) i afërm në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt;
 - d) adoptuesi apo i adoptuari;
 - e) të afërm në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë.
6. Në mungesë të vendimit për nostrifikimin e diplomës në momentin e aplikimit për emërim, kandidati obligohet që jo më vonë se 3 ditë para mbledhjes së senatit ku shqyrtohet lënda, të dorëzojë vendimin për nostrifikim të diplomës/ave. Në të kundërtën, kandidatura do të refuzohet.
7. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi mund të themelojnë marrëdhënie pune në Republikën e Kosovës sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me ligjin e veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe në përputhje me konventat ndërkombëtare.

Vendimi, periudha e ankimimit dhe përmbllja e konkursit

1. Procedura e votimit në senat për propozimet e këshillit të fakultetit lidhur me emërimin e anëtarëve të personelit akademik bëhet sipas rregullores së punës së senatit.
2. Ndaj vendimit të senatit, në afat jo më larg se 15 ditë pas pranimit në dorëzim të vendimit, mund të bëhet ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtrës, që shërben si instancë e fundit e ankimimit në UP.
3. Komisioni për ankesa dhe parashtrës nxjerr rekomandim për senatin lidhur me ankesën e shqyrtuar. Pala ankuese, pasi t'i shterë mjetet juridike të punëdhënësi, në këtë rast në Universitetin e Prishtinës, sipas Ligjit për Zyrtarë Publikë, mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.
4. Konkursi për emërimin e personelit akademik duhet të përmbillet me vendime përkatëse të Senatit të UP-së për të gjitha vendet e shpallura, sipas afateve të përcaktuara në Rregulloret për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, avancimin dhe rizgjedhjen e personelit akademik në UP.
5. Për raste të veçanta para arritjes së propozimit në senat, me kërkesë të rektorit, afati i të gjithë procedurës mund të zgjatet edhe maksimumi 30 ditë.
6. Për pozitën me numër rendor 1. të shpallur në Fakultetin e Filologjisë për Fakultetin Filozofik, procedurat e vlerësimit zhvillohen në Njësinë Akademike ku është miratuar pozita.

Mënyra e aplikimit

1. Aplikantët duhet t'i dorëzojnë të gjitha dokumentet e nevojshme online përmes [vegëzës zyrtare \(https://stafiakademik.uni-pr.edu/\)](https://stafiakademik.uni-pr.edu/), ndërsa të njëjtat duhet t'i dorëzojnë edhe në formë fizike në njësinë përkatëse akademike, ku bëhet verifikimi i dokumenteve dhe konfirmohet aplikimi online.
2. Punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare nuk ka nevojë të skanohen në tërësi, por vetëm faqja e parë dhe e fundit e punimit (përfshirë konkluzionet), ndërsa për libra dhe monografi të botuar duhet të skanohet faqja e parë e librit dhe faqja në të cilën shihet katalogimi në botim (CIP).
3. Aplikimi, përmes platformës online dhe ai fizik, do të fillojë nga data 23 dhjetor 2025 dhe do të zgjasë deri më 7 janar 2026, ora 16:00.

4. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.
5. Pas mbylljes së afatit të konkursit, nuk mund të dorëzohet asnjë dokument shtesë, as në formë të shkruar dhe as elektronike.

